



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

**Numri i lëndës:** 2021:207879

**Datë:** 08.03.2024

**Numri i dokumentit:** 05428019

**A.nr.2123/2021**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, ..... nga komuna ....., në adresën ....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson ..... me adresë në ....., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, në Prishtinë, për shkak të “anulimit të vendimit”, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të autorizuarit të palës paditëses, dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 07.03.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet kërkesëpadia e paditësit ..... nga komuna e ..... , me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë, MPMS/DFDIL-së, me numër 07-05/1324, i datës 17.06.2021, si e pa bazuar.

**A r s y e t i m**

Seanca e shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të autorizuarit të palës paditëse, dhe në mungesë të palës së paditur, e ftuar në mënyrë të rregullt (Provë: fletë-kthesa e datës 14.02.2024).

I autorizuari i paditësit ne seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, bënë zgjërimin e kërkespadiës duke kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i mëvonsëhëm i nxjerë nga e paditura e dates 17.06.2021 si i pabazuar në ligj, duke kerkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe të anulohet aktvendimi kontestues i të paditurës si i pabazuar në ligj, ashtu që paditësit ti njihet e drejta e pensionit të veteranit të UÇK-së.

E paditura, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë përmes Avokaturës Shtetërore nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor, ndërsa nëpërmes përgjigjes së dhënë në padi me datë 15.06.2023, ka theksuar se, vendimi i atakuar është i bazuar dhe pretendimet e palës paditëse për shkelje ligjore nuk qëndrojnë, për arsye se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi, ashtu që pretendimet e veta pala paditëse nuk i ka vërtetuar me asnjë provë. Mbi këto arsye i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadsisë së paditësit në tërësi si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimi i të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor – publik të datës 07.03.2023, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi i dt. 13.08.2018; kopja e letërnjoftimit të dt. 20.07.2016; vërtetimi i dt. 24.08.2018 me nr. 52; certifikata për ..... të dt. 17.01.2017 me nr. protokollit L10/733; shkresa e dt. 08.09.2020 me nr. referencë 1249; shkresa e dt. 08.09.2020 me nr. protokollit 175/20; ankesa e dt. 31.05.2018 me nr. protokollit 187/2018; vendimi i dt. 25.05.2018; vërtetimi i dt. 29.05.2018 ; vërtetimi i dt. 07.02.2018 me nr. reference 57160/2018 e lëshuar nga zyra për çështjen e kategorive të dala nga lufta; vërtetimi i dt. 14.12.2017; certifikata e lindjes për .... të dt. 08.02.2018 me nr. 05-200-88/2018; certifikata e martesës të dt. 08.02.2018 me nr. reference 05-202-41/2018; certifikata e lindjes për .... të dt. 08.02.2018; certifikata e lindjes për .... të dt. 08.02.2018; certifikata e lindjen për ..... të dt. 08.02.2018 dhe formulari për aplikim të dt. 09.02.2018, aktgjykimi i datës 13.01.2021 me numër 2158/18 dhe vërtetimi i datës 24.08.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 dhe 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, dhe pas dëgjimit të pretendimeve të palëve në procedurë, dhe pas vlerësimit të provave të administruara, konstatoi se padia e paditësit është e pa bazuar.

Me vendimin e të paditurës -Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile MPMS-DFDIL-së, si shkallë e dytë, me numër dosje 07-05/1324, të datës 17.06.2021, refuzohet ankesa e tani paditësit.

I pakënaqur me këtë vendim, paditësi më datë 17.09.2021 paraqet padi në këtë gjykatë, duke kontestuar ligjshmërinë e tij.

Gjykata kishte parasysh nenin 3 par.1 pika 1.3.2 të Ligjit Nr. 04/L -261 Për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku përcaktohet se:“1.3.2. Veteran luftëtarë i UÇK –së – është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK- së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës”.

Gjithashtu gjykata ka pasur parasysh edhe nenin 16 par.1 të Ligjit Nr. 04/L -261 Për Veteranët e Luftës Së Ushtrisë Çlirimtare Të Kosovës, ku përcaktohet se: “Veterani Luftëtar i UÇK-së, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme i sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së”.

Nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse se paditësi është Veteran Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ky fakt vërtetohet nga Vërtetimi nr.57160/2020 të datës 04.12.2020, i lëshuar nga Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mirëpo nga provat e administruara gjykata ka konstatuar se paditësi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar se i njëjti nuk është në marrëdhënie pune në sektorin publik apo në sektorin privat, sepse i njëjti nuk ka bashkangjitur Vërtetimin e ATK-së, me të cilin do të vërtetonte se nuk është në marrëdhënie pune, dokument i cili kërkohet sipas nenit 14. A, pika 1.5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr.01/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 për Procedurat e Aplikimit në Skemën e Pensioneve dhe Beneficioneve të përcaktuara në Ligjin nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, Ligji Nr.04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre dhe Ligjin nr.04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Provat të cilat i ka bashkangjitur paditësi, kanë të bëjnë me faktin se i njëjti është duke kërkuar punë dhe se nuk është duke përfituar ndonjë pension, mirëpo përmes atyre provave nuk mund të vërtetohet se i njëjti është i papunë.

Në ndërlidhje me dispozitat e lartcekura, gjykata nga provat materiale ka gjetur se paditësi nuk i plotëson kushtet për përfitimet materiale për pensionin të skemës: Veteran Luftëtar, kjo duke u bazuar në nenin 3 par.1 të Ligjit Nr. 05/L -141 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 04/L -261 Për Veteranët E Luftës Së Ushtrisë Çlirimtare Të Kosovës, ku thuhet se: 1. Neni 16 i ligjit bazik paragrafi 4 riformulohet si në vijim: 4. Të drejtën në përfitim financiar e ka vetëm Veterani Luftëtar i UÇK-së, i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj.”

Andaj, gjykata në marrjen e këtij vendimi meritor u bazua në nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është e paraparë se: “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, dhe nenin 319 I LPK-së par.1 i cili thotë se: “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”, dhe në nenin 322 par.1 i cili thotë se: “Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës” dhe 2 të LPK-së, i cili thotë se: “Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”, e ku në rastin konkret paditësi ka dështuar që të argumentoj pretendimet e tij dhe për arsyet e lartcekura gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit të dhëna në padi, por të njëjtat pretendime i refuzoi si të pabazuara, nga arsyeja se paditësi të njëjtat nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat do të ndikonin që kjo gjykatë të mund të vërtetoj një tjetër gjendje faktike. Mbi këto arsye, gjykata kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se, nuk është zbatuar ligji në dëm të njëjtit.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 67 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.2123/2021- datës 07.03.2024

G j y q t a r e

Luljeta Maxhuni

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.